

# SFIDAT E DEZINFORMIMIT DHE PROPAGANDËS SË HUAJ NË SHQIPËRI

Punuar nga: **Keisi Topi**

*(Shqyrtuar dhe mbikqyrur nga: Prof. Rrapo Zguri)*

*Punimi është realizuar si pjesë e projektit “Edukimi për Median dhe Informacionin në universitetet shqiptare: Nga pilotimi në zbatim,” të mbështetur financiarisht nga Zyra e Marrëdhënieve me Publikun të Ambasadës së SHBA në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.*

Fushatat e dezinformimit dhe propagandës së huaj mund të ndikojnë ndjeshëm në opinionin publik dhe potencialisht mund të destabilizojnë shoqëritë. Për këtë arsye studimi i këtyre fushatave, i qëllimeve dhe i tezave të tyre përbën një aspekt themelor edhe për sigurinë kombëtare dhe ndërgjegjësimin e publikut në Shqipëri

## 1.Hyrje

Raporti i Këshillit të Evropës “Ç’rregullimi Informativ: Drejt një kuadri ndërdisiplinar për studime dhe politikëbërje” e përkufizon dezinformimin si një informacion i rremë i krijuar me vetëdije për të shkaktuar dëm. (Wardle, Claire & Derakhshan, Hossein; 2017, f. 7).

Dezinformimi dallohet nga ç’informimi i cili është informacion i rremë, por jo i krijuar me qëllim për të shkaktuar dëm. Ekziston edhe një formë tjetër e ç’rregullimit informativ që quhet keq-informimi i cili është informacion që bazohet në realitet, por që shpërndahet jashtë kontekstit dhe përdoret për t’i shkaktuar dëm një personi, organizate ose vendi.

Pjesë e ç’rregullimit informativ është edhe propaganda, e cila përmban informacion të rremë, të njëanshëm ose keq-orientues që synon të mashtrrojë, manipulojë ose bindë njerëzit që të përvetësojnë një pikëpamje të caktuar politike apo ideologjike ose të mbështesin një vend, organizatë apo entitet të caktuar në qëndrimet apo iniciativat e veta.

Sipas studjuesit Artan Fuga, propoganda kërkon të bindë dhe të heqë çdo dyshim a frymë kritike; të premtojë qiejt në emër të një ëndrre delirante; të manipulojë shpirtrat; të zbukurojë aleatët; të bëjë karikaturën e kundërshtarëve; të thjeshtojë arsyetimin në dy a tri formula të gatshme; të përkëdhelë sedrën e turmave elektorale; të fshehë faktet që asaj nuk i intereson të dihen; të trumbetojë fitore gjigande me mullinjte e erës; ta bëjë të bardhën të zezë dhe të zezën të bardhë; ta interpretojë të kaluarën sipas interesave të sotme. Ajo përsërit pafund të njejtën gjë dhe banalizon gjuhën me të cilën shprehet. Ajo i di të gjitha. Propaganda braktis disa fakte që nuk i pëlqejnë dhe thekson disa fakte të montuara që nuk ekzistojnë por i krijon. Ajo shpik gjithmonë një armik. (Fuga, Artan, 2021)

Dy llojet kryesore të dezinformimit dhe propagandës të zhvilluar në Shqipëri janë:

1. dezinformimi dhe propaganda e brendshme (që prodhohet dhe përhapet nga aktorë brenda vendit për të dëmtuar aktorë të tjerë të brendshëm).
2. dezinformimi dhe propaganda e jashtme (që prodhohet dhe përhapet nga aktorë të huaj për të dëmtuar demokracinë dhe sigurinë kombëtare të Shqipërisë dhe për të krijuar pështjellime në opinionin publik brenda vendit). (Zguri, Rrapo, 2014)

Fokusi kryesor i këtij punimi përqendrohet në dezinformimin dhe propagandën e jashtme që vjen nga palë të treta si Rusia, Kina dhe Irani dhe që përhapet përmes kanaleve online, siç janë mediat online, portalet e lajmeve dhe mediat sociale.

Objektivi i këtij punimi është: Të hedhë dritë mbi shkallën e përhapjes së dezinformimit dhe propagandës së huaj në Shqipëri dhe sfidat që ato paraqesin për shoqërinë shqiptare.

Metodologjia e përdorur përfshin kërkimin në mediat online dhe rrjetet sociale përmes fjalëkyçeve dhe monitorimin e tyre për të evidentuar rastet më të spikatura të dezinformimit dhe propagandës së huaj në Shqipëri. Gjithashtu është realizuar një intervistë me një nga ekspertët e kësaj fushe.

## **2.Konteksti i marrëdhënieve të Shqipërisë me palët e treta**

### ***2.1.Marrëdhëniet e Shqipërisë me Rusinë***

Politika zyrtare e Shqipërisë në raport me **Rusinë** diktohet në masën më të madhe nga rreshtimi i Shqipërisë në një linjë me politikën e jashtme të NATO-s dhe BE (Çela, Alba; 2020) si dhe nga fakti që Rusia ka qenë haptazi kundër njohjes së shtetit të Kosovës. Këto janë edhe arsyet kryesore që marrëdhëniet aktuale mes Rusisë dhe Shqipëri janë pothuajse inekzistente, dhe që mes dy vendeve mungojnë qoftë edhe kanalet bazë të komunikimit.

Ndërkohë zhvillime sporadike, si dëbimi i diplomatit rus nga Shqipëria në janar të vitit 2021, i ka përkeqësuar edhe më tej marrëdhëniet dy-palëshe.

Analistët theksojnë se Shqipëria mbetet e shqetësuar nga prezenca e Rusisë në rajon, dhe veçanërisht nga marrëdhëniet intensive ekonomike me Malin e Zi si dhe lidhjet e gjera dhe të shumanshme me Serbinë. (Çela, Alba; 2020)

Në rastin e Serbisë, marrëdhëniet me Rusinë kanë avancuar dukshëm, sidomos pas vitit 2013, kur qeveritë e të dy vendeve nënshkruan marrëveshjen e Partneritetit Strategjik. Një vit më vonë Serbia nisi stërvitjet e përbashkëta ushtarake me Rusinë, dhe në 2015 mori pjesë edhe në manovrat tre-palëshe ushtarake me Rusinë dhe Bjellorusinë. Në të njëjtën kohë, Serbia bleu një sasi armësh të sofistikuar nga Rusia. (Subotić, Strahinja, 2020, f. 81)

Studjuesi Srećko Đukić nënvizon se “Rusia është një vend me një rol historik të konsiderueshëm në Ballkan dhe është e aftë të presë që ne të mbështetemi tek ajo si në një shtyllë të domosdoshme tek e cila ne mund të kthehemi sa herë që gjendemi në situata të vështira”. (Đukić, Srećko; 2015)

### ***2.2.Marrëdhëniet e Shqipërisë me Kinën***

Ashtu si marrëdhëniet me Rusinë, edhe marrëdhëniet aktuale të Shqipërisë me **Kinën**, ndikohen në masë të madhe nga marrëdhëniet e SHBA me superfuqinë aziatike, të cilat u përkeqësuan gjatë presidencës së parë të Trump. Pikërisht në këtë periudhë Shqipëria iu bashkua listës së vendeve të *Clean Network* të cilat kufizojnë apo ndalojnë firmat kineze që të hyjnë në tregun digjital të tyre me planet ambicioze për rrjetin 5G. (Çela, Alba; 2020)

Gjithsesi, edhe pse në mënyrë të ngadaltë, marrëdhëniet dypalëshe mes Shqipërisë dhe Kinës kanë ardhur duke u zgjeruar. Kompania kineze Geo-Jade prej disa vitesh ka marrë për shfrytëzim zonën naftë-mbajtëse Patos-Marinëz. Ndërkohë kompania tjetër China Everbright Group mori me konsension për disa vjet aeroportin e vetëm ndërkombëtar të vendit “Tirana International Airport”.

Ndikimi i Kinës në Shqipëri ka qenë kryesisht i natyrës ekonomike dhe ka kaluar përmes marrëdhënieve dy-palëshe, por edhe përmes inisiativës 17+1, e quajtur ndryshe “Samiti Kinë-CEE

- Central and Eastern European Countries) i cili zuri fill në vitin 2012 dhe përfshin 11 vende të BE si dhe 5 vende të Ballkanit Perëndimor: Shqipërinë, Bosnje-Hercegovinën, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Serbinë. Kjo inisiativë është një lloj zgjatimi i *China's Belt and Road initiative* (Inisiativa kineze “Një brez, një rrugë”), që ka tre prioritete: Investimet në infrastrukturë, në teknologjitë e avancuara dhe në teknologjitë e gjelbra.

Edhe pse marrëdhëniet dy-palëshe po intensifikohen gradualisht, ky intensifikim paraqitet i fragmentuar dhe në dukje jo koherent si dhe në një nivel mjaft të ulët institucionalizimi. Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO duket se po bllokton rrugën për lidhje më të thella në fushën e sigurisë dhe teknologjisë me Kinën. (Zguri, Rrapo, 2021)

### **2.3. Marrëdhëniet e Shqipërisë me Iranin**

Sipas autorëve të studimit “*Analizë e mediave: Propaganda e Iranit në gjuhën shqipe*” marrëdhëniet diplomatike mes Shqipërisë dhe Iranit që u vendosën në vitin 1999 kanë qenë historikisht të ndërlikuara dhe, kohët e fundit, mjaft të tensionuara. Irani është përpjekur të shtrijë ndikimin e tij kulturor në Shqipëri nëpërmjet aktiviteteve të tilla si financimi i botimeve fetare dhe letrare dhe krijimi i shoqatave aktive iraniane. Megjithatë, marrëdhëniet u përkeqësuan ndjeshëm kur Shqipëria akuzoi Iranin si autor të një sulmi masiv kibernetik të ndërmarrë ndaj infrastructures së saj digjitale në verën e vitit 2022. (Bino, Bleriana & Likmeta, Besar, 2023)

Një tjetër çështje serioze që çon në mosmarrëveshjeje mes dy vendeve është strehimi nga Shqipëria i Muxhahedinëve El-Khalq (MEK), një grup opozitar iranian që synon të rrëzojë qeverinë teokratike të Iranit. Me rreth 3,000 anëtarë të MEK-ut të vendosur aktualisht në kampin Ashraf-3 në Shqipëri, Irani e konsideron mbështetjen e Shqipërisë për këtë grup si provokim të drejtpërdrejtë. Prania e MEK-ut, e kombinuar me incidentin e fundit të sulmit kibernetik, ka përshkallëzuar tensionet mes dy shteteve, që duket se ndikon në peizazhin e gjerë gjeopolitik dhe te negociatat e vazhdueshme për programin bërthamor të Iranit. (Bino, Bleriana & Likmeta, Besar, 2023-2)

Në këtë kuadër, analizimi i diplomacisë publike të Iranit në Shqipëri përmes mediave të tij të sponsorizuara nga shteti është një detyrë e rëndësishme dhe e kohës, veçanërisht duke qenë se lufta e informacionit përbën një komponent kryesor të strategjisë moderne gjeopolitike.

## **3. Format, kanalet dhe tezat kryesore të dezinformimit dhe propagandës së huaj në Shqipëri që vjen nga palët e treta**

Analiza e formave dhe e tezave kryesore të dezinformimit dhe propagandës së huaj është një proces shumë i rëndësishëm për të kuptuar shkallën e përhapjes së tyre, sfidat që ato paraqesin për shoqërinë shqiptare, ndikimin në fusha të ndryshme si dhe për të hedhur dritë mbi synimet e vendeve nga të cilat burojnë këto forma të çrregullimit informativ.

### **3.1. Format, kanalet dhe tezat kryesore të dezinformimit dhe propagandës që vjen nga Rusia**

Rusia përdor forma të drejtpërdrejta dhe të fshehta për të përhapur narrativat e saj dhe për të zgjeruar shtrirjen e fushatave të saj të dezinformimit në Perëndim dhe në mbarë botën. Kanalet kryesore të fushatave të dezinformimit të Rusisë janë mediat e saj të sponsorizuara nga shteti, RT dhe Sputnik. RT ka një rrjet prej tetë kanalesh televizive – i fundit i hapur në Beograd, Serbi – dhe Sputnik kontrollon rreth 30 faqe interneti në gjuhë të ndryshme, të ndërtuara me synimin për t'i shërbyer qëllimeve të politikës së jashtme të Kremlinit. (Bino, Bleriana & Likmeta, Besar, 2023-1).

Tezat kryesore të dezinformimit rus janë:

- Tezat në mbështetje të politikës ndërkombëtare ruse
- Tezat e nostalgjisë dhe të “borxhit” historik ndaj Rusisë. (Zguri, Rrapo; 2021).

Në mesin e narrativave apo tezave në mbështetje të politikës ndërkombëtare ruse të zbuluara nga kërkimi në mediat online, mund të përmendim: NATO dhe SHBA janë agresivë dhe kërcënim për Rusinë; Ukraina drejtohet nga një qeveri naziste; Perëndimi po pengon përpjekjet e paqes në Ukrainë; Ukraina ka armë biologjike që janë një kërcënim për fqinjët, (Bino, Bleriana & Likmeta, Besar, 2023-1); Rusia nuk po e pushton Ukrainën por po kryen një operacion ushtarak për të mbrojtur rusët e Ukrainës, Kosova është çështje e Serbisë, etj.

Në mediat shqiptare janë shfaqur edhe qëndrime pro-ruse apo që revokojnë nostalgjinë apo “borxhin” historik ndaj Rusisë. (Zguri, Rrapo; 2021). Përmes rimarrjes dhe rikontekstualizimit të së kaluarës, një autor, flet për kontributin e Leninit (duke e vënë atë në krah me presidentin amerikan Thomas Woodrow Wilson) dhe të Rusisë (duke e vënë atë në krah me SHBA) për përkrahjen e tyre ndaj shtetit shqiptar në fund të shekullit të 19-të dhe fillim të shekullit të 20-të. I njejtë autor në terma nostalgjikë dhe në një përpjekje për të kujtuar borxhet që Shqipëria i ka Rusisë, shkruan: “Rusia në 1948-1949, në kohën e krizës për bukë, na solli një vapor plot me grurë falas, dhe deri në vitin 1961 na ndihmoi të ngrinim institucionet, Universitetin shtetëror, fabrika dhe uzina, Kinostudion Shqipëria e Re, na ngriti mirëqënien sidomos gjatë viteve 59-60, si dhe na armatosi..” Një narrativë e tillë, është në përputhje dhe në shërbim të interesave ruse.

Nga analiza e thelluar e studimit të bërë nga BIRN, “Narrativat disinformuese Ruse në mediat Shqiptare” janë evidentuar edhe narrativa të tjera pro-Kremlin në mediat shqiptare që janë rishpërndarë disa herë. Ky studim i bazuar në publikimet e ardhura nga Task Forca Lindore e Stratcom e EEAS në bazën kryesore të të dhënave të EUvsDisinfo është bërë për periudhën Janar-Gusht 2022. Nga 384 rastet e dezinformimit të përgënjeshtuar nga EUvsDisinfo, 86 prej tyre pra 22% u shpërndanë nga mediat në gjuhën shqipe në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. (Voko, Kristina & Likmeta, Besar, 2023)

Nga hulumtuesit u zbuluan 377 artikuj dhe video në disa media që shpërndanin informacione të rreme të sajura nga Rusia. 65% të këtyre lajmeve u botuan në mediat shqiptare, 19% në mediat shqip në Kosovë, 9% në mediat e Maqedonisë së Veriut dhe 7% nga agjenci lajmesh të sponsorizuara nga Irani dhe Turqia përmes shërbimeve dhe faqeve të internetit në shqip. Pjesa më e madhe, 61% qarkullon në portale lajmesh, 19% në faqet online të televizioneve, 12% në gazetat

e televizioneve, 15% ne faqet e internetit të agjensive të lajmeve dhe 3% në faqet e stacioneve radiofonike dhe revistave. Pjesa dërrmuese janë artikuj të shkruar ndërkohë që vetëm 4 raste janë video në YouTube. (Voko, Kristina & Likmeta, Besar, 2023)

Dezinformimi rus ne mediat sociale shqip ka ardhur në disa raste edhe nga Ambasada Ruse në Tiranë. Ajo ka postuar 322 postime në rrjetin Facebook ku 127 nga ato ishin të rreme. Psh. rasti i 150 mercenarëve shqiptarë ne Ukrainë, ku 42 ishin vrarë. (Voko, Kristina & Likmeta, Besar, 2023).

Po ashtu web-faqe të ndryshme të institucioneve shtetërore dhe private të Shqipërisë kanë rënë pre e një sulmi kibernetik, që dyshohet të jetë bërë nga hakerat pro-rusë. Grupi quhet Noname057 dhe është bërë i njohur në vitin 2022 si një grup aktivist i paorganizuar dhe i lirë që kërkon të tërheqë vëmendje në vendet perëndimore në aplikacionin Telegram.

### ***3.2. Format, kanalet dhe tezat kryesore të dezinformimit dhe propagandës që vjen nga Kina***

Forma kryesore e ç'rregullimit informativ që vjen nga Kina është propaganda. Por nuk mungojnë edhe rastet e dezinformimit. Gjatë dekadës së fundit, regjimi kinez ka zgjeruar investimin e tij në aftësinë e mediave shtetërore për të arritur audiencën globale. Kanalet kryesore të dezinformimit dhe propagandës kineze janë: China Global Television Network (CGTN), China Radio International (CRI), dhe China Daily Xinhua News Agency të cilat i kanë programet e tyre edhe në shumë gjuhë të huaja. Por ata përdorin gjerësisht edhe mediat sociale dhe platformat ndërkombëtare online.

Kanali kryesor i propagandës dhe dezinformimit kinez në gjuhën shqipe është China Radio International (CRI) në shqip dhe Radio Ejani, përfshirë edhe faqet e tyre në rrjetet sociale. Por propagandë vjen edhe nga faqet online në shqip të Ambasadës së Kinës në Shqipëri.

Një pjesë dezinformimit dhe propagandës kineze është shfaqur edhe në mediat shqiptare online. Kështu, një portal boton shkrimin me titull “Mekanizmi 17 + 1 si përçues shprese e optimizmi për të ngadhënjyer mbi të keqen nëpërmjet artit”, në të cilën glorifikohet roli i Kinës, e cila “është bërë ndër promotorët më të rëndësishëm të zhvillimit të këtij rajoni të gjërë të Europës në sektorë të ndryshëm si infrastrukturë, transport, tregti, logjistikë, si dhe shëndetësi, kulturë, arsim dhe fusha të tjera të interesit të përbashkët.”

Gjithashtu ky portal përmes këtij shkrimi informon publikun e vet për deklaratën e Kryetarit të Partisë Komuniste të Kinës dhe njëherësh President i vendit, se sesioni i pestë plenar i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës ka hartuar plane gjithë-përfshirëse për zhvillimin e Kinës në Planin e 14-të pesëvjeçar (2021-2025), dhe se Kina është pranë arritjes së objektivave të ndërtimit të një shoqërie të zhvilluar në mënyrë të moderuar në të gjitha fushat dhe të çrrënjosjes së varfërisë. Siç vihet re narrativa e këtij shkrimi është tipikisht ajo e propagandës komuniste, të cilët shqiptarët e kanë akoma të freskët në kujtesën e tyre.

Ne raportin e IDRA publikuar në mars 2024 *“Preserving democratic values in the face of propaganda and disinformation”* theksohet se: “Përpyqjet propagandistike të Kinës në Shqipëri u vëzhguan kryesisht përmes bashkëpunimeve me media të vendit si RTSH, duke prodhuar dokumentarë dhe programe radiofonike. Kina synon strategjikisht të forcojë imazhin dhe ndikimin e saj në Shqipëri, veçanërisht në sferat ekonomike dhe kulturore. Gjithashtu etiketa “Made in China” gjendet në shumë produkte në Shqipëri dhe konsiderohet nga pjesëmarrësit e publikut të gjerë si propaganda më e madhe ekonomike.

Bashkëpunimi me RTSH për dokumentarin mbi Xi Jinping shihet si propagandë flagrante. Duke analizuar dokumentarin, kemi evidentuar disa fjali që duken qartë që janë një propagandë Kineze.

1-Shqipëria ka pasur një rritje domethënëse ekonomike në vitet 1970 vetëm nga marrëdhëniet me Kinën.

2-Në 5 dekadat e fundit Kina ka qënë një fuqi e madhe e përgjegjshme e OKB-së

3-Kina ka dhënë ndihmë materiale në mbi 170 vende gjatë pandemisë dhe ka eksportuar furnizime në mbi 200 vende të rajonit.

4-Kina është një histori suksesi global.

5-Ministri i Jashtëm Kinez, për 50 vjetorin e ri-anëtarësimit të Kinës në OKB vizitoi Shqipërinë për t’i shprehur falenderimet qeverisë shqiptare që e ndihmoi në vitet ‘70 për t’u bërë prapë pjesë e OKB-së.

CGTN shqip është një version në gjuhën shqipe i kanalit ndërkombëtar të lajmeve CGTN (China Global Television Network). Në këtë faqe mund të gjelesh kategori të ndryshme lajmesh si: Kina , Shqipëria e Rajoni, Bota, Analiza, Ekonomi, të gjitha në gjuhën shqipe. Vetëm në 15 ditët e para të muajit dhjetor ajo ka postuar 100 lajme mbi ngjarjet e fundit në Shqipëri.

### ***3.3. Format, kanalet dhe tezat kryesore të dezinformimit dhe propagandës që vjen nga Irani***

Kanali kryesor i dezinformimit që përdoret nga Shteti islamik i Iranit është Agjencia e Lajmeve Pars Today, e cila transmeton edhe në gjuhën shqipe.

Sipas profesorit të gazetarisë dhe të komunikimit, Rrapo Zguri, linjat kryesore të diskursit dezinformues iranian janë:

- Retorika armiqësore ndaj SHBA dhe aleatëve të tyre
- Retorika armiqësore ndaj Izraelit dhe kombit hebre
- Retorika anti-BE dhe anti-perëndim
- Demonizimi i sistemit të demokracisë liberale
- Diskursi i dobësimit dhe rënies së rolit të BE në rajon dhe botë.

Ja disa shembuj shkrimesh në të cilat shfaqen disa nga këto linja diskursi:

1-Titulli i shkrimit: ***FBI thotë se vrasjet u rritën vitin e kaluar në SHBA.***

Ky lajm është publikuar në Agjensinë e lajmeve Pars Today në anglisht në 7 Tetor 2022. Ai është një përpjekje për të errësuar realitetin në SHBA. Ja çfarë thuhet në të: “Ndërsa zyrtarët e FBI shprehën besim në saktësinë e përgjithshme të vlerësimeve të tyre, ekspertët thanë se të dhënat nuk paraqesin një pamje të plotë të tendencave të vrasjeve në SHBA. Megjithëse raporti i ri sugjeron se rritja e madhe e vrasjeve gjatë pandemisë tani është ulur, shkalla e vrasjeve është ende shumë më e lartë se para pandemisë.”

2- Titulli i shkrimit: ***Akuza e re e trojkës së BE-së kundër programi bërthamor paqësor të Iranit.***

Pars Today- Trojka evropiane (Gjermania, Franca dhe Britania), duke lëshuar një deklaratë të hënën, në reagim ndaj raportit të fundit të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike për rritjen e prodhimit të uraniumit në Iran me pasurim 60%, përsëriti akuzat e tyre politike kundër Programit bërthamor paqësor i Iranit.

Akuzat e trojkës së re të BE-së kundër programit bërthamor paqësor të Iranit janë ngritur ndërkohë që ata kanë injoruar qëllimisht rolin e tyre në zhgënjimin e JCPOA përmes mosveprimit dhe moszbatimit të detyrimeve të tyre pas daljes së paligjshme të SHBA-së nga JCPOA në maj 2018, dhe sapo janë fokusuar në reagimet e Iranit dhe duke i zmadhuar ato në përpjekje për të justifikuar sjelljen e tyre aktuale, përkatësisht rritjen e presioneve politike kundër Iranit.

3- Titulli i shkrimit: ***Një vështrim mbi pikëpamjet e përdoruesve të X: Roli i Izraelit në Siri dhe përfitimet e mëdha të prodhuesve amerikanë të armëve.***

Ky lajm është botuar në Pars Today shqip në 11 dhjetor 2024. Aty bëhet fjalë për përfitimet e mëdha të prodhuesve amerikanë të armëve nga lufta e Ukrainës

Aktivisti anglisht-folës i Rrjetit X me emrin e përdoruesit "East Briddenham" flet për përfitimet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës nga vazhdimi i dërgimit të armëve në Ukrainë në kuadër të luftës së Uashingtonit kundër Rusisë dhe pohon: "Ne dërgojmë armët tona më të vjetra në Ukrainë dhe do t'i zëvendësojmë ato me armët e reja të prodhuara në fabrikat amerikane".

Sipas këtij përdoruesi të X, qendrat e prodhimit të armëve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës nxjerrin fitime të mëdha duke furnizuar Ukrainën me armë nga pikëpamja ushtarake dhe ekonomike.

Një përdorues me emrin “Saleh” gjithashtu kritikon vendet perëndimore në rrjetin social X për gjoja përpjekjen për të mbrojtur të drejtat e njeriut në botë dhe thotë: “Zoti zbuloi fytyrën e vërtetë të Perëndimit për botën dhe brezat e ardhshëm përmes duarve të Izraelit. Unë do të ta hesht me këpucët e mia çdo gojë perëndimore që thotë se jemi njerëz të lirisë dhe të të drejtave të njeriut”.

Irani i shfrytëzon shumë mediat për të formësuar perceptimin publik në përputhje me interesat dhe ideologjinë e tij gjeopolitike. Ai portretizon vendet perëndimore negativisht ndërkohë që Rusinë e perfaqëson si një aktor të suksesshëm global.

#### **4. Përfundime**

***Ndikimit i dezinformimit dhe propagandës të huaj:*** Dezinformimi dhe propaganda në Shqipëri, si nga aktorë të brendshëm ashtu edhe nga ata të huaj, janë një sfidë e madhe për vendin tonë. Ato mund të destabilizojnë shoqërinë, të ndikojnë negativisht në opinionin publik të dëmtojnë demokracinë dhe sigurinë kombëtare dhe të ndikojnë në marrëdhëniet ndërkombëtare të Shqipërisë.

***Rusia, Kina dhe Irani si burime kryesore të propagandës dhe dezinformimit:*** Shtetet e huaja, si Rusia, Kina dhe Irani, kanë përdorur kanale të ndryshme për të shpërndarë narrativa që ndihmojnë për të manipuluar opinionin publik shqiptar. Kjo përfshin përdorimin e mediave shtetërore, portaleve të lajmeve dhe rrjeteve sociale për të promovuar informacion të pasaktë.

***Format dhe kanalet e dezinformimit:*** Rusia është një nga aktorët kryesorë që përdor forma të drejtpërdrejta dhe të fshehta për të shpërndarë dezinformata. Kanale si RT dhe Sputnik janë të përhapura dhe ndikojnë në media shqiptare, duke promovuar narrativa që mbështesin politikën e jashtme të Kremlinit dhe përpiqen të krijojnë ndasi mes Shqipërisë dhe aleatëve të saj ndërkombëtarë, veçanërisht për sa i përket çështjes së Kosovës.

Kanalet kryesore të dezinformimit dhe propagandës kineze janë: China Global Television Network (CGTN), China Radio International (CRI), dhe China Daily Xinhua News Agency të cilat i kanë programet e tyre edhe në shumë gjuhë të huaja. Por ata përdorin gjerësisht edhe mediat sociale dhe platformat ndërkombëtare online. Kurse kanali kryesor i dezinformimit që përdoret nga Shteti islamik i Iranit është Agjensia e Lajmeve Pars Today, e cila transmeton edhe në gjuhën shqipe.

***Propaganda dhe dezinformimi në mediat sociale:*** Mediat sociale luajnë një rol të madh në shpërndarjen e dezinformimit. Ambasada ruse në Tiranë dhe grupe të tjera pro-ruse kanë shpërndarë informacione të rreme përmes postimeve në rrjete sociale si Facebook, përfshirë pretendime të pasakta për shqiptarët që luftojnë në Ukrainë dhe për përpjekje për të diskredituar politikën e qeverisë shqiptare.

***Kundërpërgjigjet dhe sfidat për Shqipërinë:*** Shqipëria duhet të zhvillojë strategji të qëndrueshme për të parandaluar dhe luftuar dezinformimin, përfshirë edukimin e publikut për rreziqet e propagandës dhe rritjen e mbështetjes për mediat e pavarura. Kjo kërkon bashkëpunim me aleatët ndërkombëtarë dhe investime në kapacitete të sigurta të teknologjisë dhe komunikimit.

## **BIBLIOGRAFIA DHE WEBLIOGRAFIA**

Agjensia iraniane e lajmeve “Pars Today”, Link: <https://parstoday.ir/sq>

Bino, Bleriana & Likmeta, Besar, (2023-1), *Analizë e mediave: Diplomacia publike e Kinës në Shqipëri*, BIRN Albania & SCIDEV, Tirana

Bino, Bleriana & Likmeta, Besar, (2023-2), *Analizë e mediave: Propaganda e Iranit në gjuhën shqipe*, BIRN Albania & SCIDEV, Tirana

Çela, Alba; (2020) *Albania and the Influence of Outside Actors*, In: “The strategic role of external actors in the Eastern Balkans”, Published by: Eilfried Martens Centre for European Studies and the Political Academy of the Austrian People’s Party, December 2020.

Đukić, Srećko; (2015), *Serbia's relations with Russia: an overview of the post-yugoslav (post-soviet) era*” Në: The challenges of Serbia's foreign policy, Belgrade, Botim i European Movement Serbia, Mbështetur nga Friedrich Ebert Stiftung

Fuga Artan, (2021) *Njeriu Fëmijë*, Papirus, Tiranë

Intervistë me Dr. Rrapo Zguri, pedagog në departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit të UT, 12 dhjetor 2024.

*Preserving democratic values in the face of propaganda and disinformation*, (2024), IDRA, Tiranë

Radio e Jashtme e Kinës në shqip: Link: <https://albanian.cri.cn/index.htm>

Radioja kineze në gjuhën shqipe “Ejani”, [https://www.facebook.com/CMGShqip/?locale=sq\\_AL](https://www.facebook.com/CMGShqip/?locale=sq_AL)

Subotić, Strahinja; *Serbia: The Hub for External Actor Involvement*, In: “The strategic role of external actors in the Western Balkans”, Published by: Eilfried Martens Centre for European Studies and the Political Academy of the Austrian People’s Party, December 2020, f. 81

Voko, Kristina & Likmeta, Besar, (2023), *Narrativat dezinformuese ruse në median shqiptare*, BIRN Albania, Tirana

Zguri, Rrapo, (2023) *Disinformation in Southeastern Europe - The case of Albania*, Botuar në “Blurring the truth - Disinformation in Southeastern Europe”, Sofie

Zguri, Rrapo; (2021) *Nga fqinjët tek fuqitë e mëdha – lajmi ndërkombëtar në mediat shqiptare*, Botuar nga ISHM me mbështetjen e Friedrich Ebert Stiftung, Tiranë

*Will China’s ‘16+1’ Format Divide Europe?*, April 11, 2019, Center for Strategic and International Studies, Link: <https://www.csis.org/analysis/will-chinas-161-format-divide-europe>

Wardle, Claire & Derakhshan, Hossein; (2017), *Ç’rregullimi informativ: Drejt një kuadri ndërdisiplinar për studime dhe politikë-bërje*; Raport i Këshillit të Evropës.